

Dardena
dt 29.01-2026
KdG

PARASHTRIME DHE KËRKESA

KËRKUES: Jamarbër Malltezi, me nr. personal H21109073R, banues në Tiranë në rrugën "Mustafa Matohiti", pallati Nr. 7, apartamenti 8.

OBJEKTI: Deklarimin e mbarimit të mandatit të "magjistratit" për Gjyqtaren Irena Gjoka, gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
Pavlefshmërinë e emërimit të gjyqtarës Irena Gjoka në Gjykatën e Posaçme të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Baza ligjore: 33, 45, 47 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Nenet 6/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 28, 64, 66, 162/1 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ligji nr. 138/2015 dhe Vendimi nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë.

Vendimi i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut Besnik Cani kundër Shqipërisë (Kërkesa nr. 37474/20).

DREJTUAR: Këshillit të Lartë Gjyqësor

Të Nderuar Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Siç kemi parashtruar në kërkesat tonë të vazhdueshme, të cilat fillojnë që nga data 09.05.2025, në datën 04.03.2024 në disa media u bënë publike disa fakte që kishin të bënin me ekzistencën e një vendimi penal dënimi nga autoritetet gjyqësore greke ndaj gjyqtarës Irena Gjoka (Maneku) si dhe dy masave ndalimi për të hyrë në një vend të Bashkimit Europian, për cënim të rendit publik. Po në këtë datë Këshilli i Lartë Gjyqësor ka nxjerrë një deklaratë për shtyp, duke refuzuar verifikimin e vërtetësisë së informacionit.

2. Në vijim, nga korrespondenca e Prokurorisë së Përgjithshme me Znj. Adriana Kalaja, bërë publike, rezulton që prej Këshillit të Lartë Gjyqësor është kërkuar verifikimi i thelluar në lidhje me subjektin Irena Gjoka (Maneku) në datën 07.05.2024, ndërkohë që sipas parashikimeve të nenit 8 të ligjit nr. 138/2015, verifikimi i thelluar i formularit të dekriminalizimit duhet të kërkohej të fillohet nga organi i ngarkuar me ligj, në këtë rast Këshilli i lartë Gjyqësor, brenda 5 ditëve nga publikimi i fakteve.

3. Në datën 09.05.2025 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kam paraqitur kërkesën me objekt “Deklarimin e mbarimit të mandatit të “magjistratit” për Gjyqtaren Irena Gjoka, gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”. Kërkesa e paraqitur prej meje vinte në dijeni Këshillin e Lartë Gjyqësor, për ekzistencën shkaqeve kushtetuese sipas nenit 6/1 të Kushtetutës, për deklarimin e mbaruar të mandatit të magjistratit, për gjyqtaren në detyrë Irena Gjoka (Maneku), për shkak të vërtetimit të rrethanave që çenojnë integritetin e funksionarit publik sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me tre ligje të miratuara me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, dhe mbështetëj në prova shkresore me vlerë të plotë provuese, konkretisht vendimi nr. 1447/2005 i Gjykatës Penale të Shkallës së Parë Janinë në formën e parashikuar në ligj.

4. Me shkresën nr. 2610/3 datë 14.05.2025 Këshilli i Lartë Gjyqësor më ka njoftuar se i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me kërkesë për vendosjen në dispozicion të rezultateve të deritanishme të hetimit të kryer prej saj. Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka vijuar me njoftimin nëse është dërguar përgjigje nga Prokuroria e Përgjithshme.

5. Në vijim, prej nesh është kundërshtuar mosveprimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor me kërkesën datë 19.05.2025, në të cilën kemi parashtruar se “Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 28 dhe 66 të ligjit nr. 96/2016 është i detyruar të shprehet me vendim brenda 2 javëve në lidhje me mbarimin e mandatit të gjyqtarës në detyrë Irena Gjoka (Maneku), pasi njoftimi për shkaqet e mbarimit të mandatit të saj është marrë nga Këshilli në datën 08.05.2025, dhe vendimi nr. 1447/2005 i Gjykatës Penale të Shkallës së Parë Janinë është dorëzuar nga kërkuuesi në formën e parashikuar në ligj. Nëpërmjet legalizimit “apostille” vërtetohet që është origjinal dhe është lëshuar nga Gjykatës Penale të Shkallës së Parë Janinë. Nëpërmjet përkthimit të legalizuar vërtetohet përmbajtja e tij nga e cila rezulton që gjyqtarja në detyrë Irena Gjoka (Maneku) është e dënuar me vendim penal për kryerjen e një krimi.”.

6. Me shkresën nr. Prot 2610/6 datë 27.05.2025 nga ana e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kemi marrë përgjigjen se: “Verifikimi i shkaqeve të pazgjedhshmërisë për një magjistrat kryhet nga Këshilli në përputhje me parashikimet ligjore të Nenit 28 në lidhje me Nenin 6 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Po ashtu në këtë njëjtën shkresë Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor shprehet se organi kompetent për kryerjen e verifikimeve ligjore jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pranë organeve të juridiksioneve të juaja, është Prokuroria e Përgjithshme.

7. Me shkresën datë 16.07.2025, në vijim të korrespondencës me Këshillin e Lartë Gjyqësor, kemi kundërshtuar përgjigjen e dhënë me shkresën nr. Prot 2610/6 datë 27.05.2025, pasi referuar neneve 28 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli, sipas nenit 32 të ligjit, kryen verifikime në lidhje me shkaqet e pazgjedhshmërisë së kandidatit për magjistrat duke kërkuar dhe marrë informacion nga çdo subjekt fizik apo juridik. Pra zbatimi i nenit 28 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i jep të drejtë Këshillit të Lartë Gjyqësor të kryejë

hetime kryesisht, dhe të kërkojë dhe marrë informacion pranë çdo subjekti ku ndodhet informacioni. Referuar nenit 2 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka përkufizim të termit “autoriteti kompetent”. Në zbatim të nenit 147/1 të Kushtetutës “**autoriteti kompetent**” i ngarkuar nga Kushtetuta për garantimin e përgjegjshmërisë së pushtetit gjyqësor është pikërisht Këshilli i Lartë Gjyqësor.

8. Kërkuesi pasi ka ardhur në dijeni të shkresës nr. 183/65 extra datë 03.09.2025 të Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, drejtuar Av. Adriana Kalaja, nga përmbajtja e së cilës rezultojnë: **“Deri aktualisht me shkresën nr. 216/7 prot., datë 15.07.2025 Ministria e Drejtësisë ka përcjellë përgjigjen e autoriteteve gjyqësore greke në lidhje me kërkesën tonë nr. 183/49 prot. Datë 07.05.2025, nëpërmjet së cilës konfirmojnë se vendimi është autentik dhe nuk është ekzekutuar për shkak të aktit të Prokurorit. Bashkëlidhur është dërguar një kopje e njehsuar me origjinalin e këtij vendimi.”**, në datën 14.10.2025 Kërkuesi ka paraqitur kërkesë tjetër për deklarimin e mbaruar të mandatit të magjistratit të gjyqtarës Irena Gjoka në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

9. Me shkresën nr. 4038/3 datë 29.10.2025 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka njoftuar Kërkuesin, se i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me kërkesë për vendosjen në dispozicion të rezultateve të deritanishme të hetimit të kryer prej saj. Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka vijuar me njoftimin nëse është dërguar përgjigje nga Prokuroria e Përgjithshme.

10. Në datën 20.01.2026 Prokuroria e Përgjithshme nëpërmjet njoftimit zyrtar ka bërë publik faktin se ka përfunduar procedurën e verifikimit të thelluar të formularit të dekriminalizimit të subjektit Irena Gjoka dhe në datën 19.01.2026 ka dërguar relacionin përkatës në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

11. Kërkuesi i është drejtuar me kërkesë përsëri Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 23.01.2026, me të cilën, bazuar në nenin 45 të Kodit të Procedurave Administrative, ka kërkuar informacion në lidhje me relacionin e dorëzuar nga Prokuroria e Përgjithshme, dhe bazuar në nenin 47 të të njëjtit Kod, ka depozituar dokumentacion shtesë, si dhe ka përsëritur kërkesën për deklarimin e mbaruar të mandatit të magjistratit të gjyqtarës Irena Gjoka.

12. Në datën 23.01.2026 është publikuar një akt “Parashtrime” e subjektit Irena Gjoka, Maneku, *“Analizë Juridike në kuadër të Verifikimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme për Gjyqtaren Irena Gjoka, në kuadër të ligjit të dekriminalizimit si dhe analizë juridike për kushtet e zgjedhshmërisë në bazë të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*.

13. Në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor, pavarësisht detyrimit që brenda 5 ditëve të më vendoste në dispozicion akteve sipas nenit 45 të Kodit të Procedurave Administrative, nuk më ka vendosur në dispozicion aktet e dosjes administrativ, si dhe prej subjektit subjektit Irena Gjoka, Maneku, nuk është bërë përgënjeshttrim zyrtar që akti “Parashtrime” *“Analizë Juridike në kuadër të Verifikimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme për Gjyqtaren Irena Gjoka, në kuadër të*

ligjit të dekriminalizimit si dhe analizë juridike për kushtet e zgjedhshmërisë në bazë të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nuk është përpiluar dhe dorëzuar prej saj, prezumoj që sa është publikuar është opinioni dhe qëndrimi i saj në lidhje me faktet në ngarkim të saj të cilat janë bërë publike.

14. Duke qënë palë e interesuar në procedurën administrative, jo vetëm si subjekti që ka paraqitur kërkesë për deklarimin e mbaruar të mandatit të magjistratit të gjyqtarës Irena Gjoka, por edhe si i dëmtuar drejtëpërsëdrejti nga veprimtaria e saj në konflikt interesi, dhe në kushtet e mbarimit të mandatit që në datën 22.11.2016 (kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 96/2016), paraqes Parashtrimet e mia, që kërkoj të merren në shqyrtim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me aktet e tjera.

A. Në lidhje me objektin e kërkesës "Për deklarimin e mbarimit të mandatit të magjistratit" të gjyqtarës Irena Gjoka (Maneku)".

15. Në nenin 6/1 të Kushtetutës është parashikuar se: "Ndalohet zgjedhja, emërimi apo ushtrimi i një funksioni publik në një nga organet e parashikuara në këtë Kushtetutë, ose të krijuara me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bërë në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute, nëse verifikohen rrethanat që çenojnë integritetin e funksionarit publik sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit."

16. Gjykatat e Posaçme janë institucione të parashikuara në Kushtetutë, neni 135/2 i saj, pra legjislatori i ka dhënë rëndësi të posaçme këtyre institucioneve, për pasojë ka vlerësuar se integriteti i këtyre insitucioneve është mjaft i rëndësishëm.

17. Në lidhje me "integritetin" e subjekteve që ushtrojnë funksionin në gjykatat e posaçme legjislatori ka miratuar të paktën katër ligje me 3/5, tre prej të cilëve parashikojnë detyrime për Këshillin e Lartë Gjyqësor, ligji nr.138/2015, ligji nr. 95/2016, ligji nr. 96/2016. Ligji nr. 84/2016 i miratuar edhe ky me 3/5, nuk parashikon të drejtën e Këshillit të Lartë Gjyqësor të ndërpresë mandatin e magjistratit, por ka parashikuar dy institucione të tjera kushtetuese, Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

18. Në rastin e magjistrates Irena Gjoka të gjitha institucionet e ngarkuara me ligj për verifikimin e rrethanave që kanë të bëjnë me verifikimin e kushteve të vazhdimit të mandatit të saj të magjistratit kanë dështuar, megjithëse janë vënë në dijeni publikisht për ekzistencën e të dhënave sipas të cilave mandati i saj si "magjistrate" duhet të kishte përfunduar.

19. Për herë të parë me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, si dhe me ligjet e tjera të paketës së drejtësisë të vitit 2016 është parashikuar "mbarimi i mandatit të magjistratit". Po ashtu në nenin 138/2015 dhe në Vendimin e Kuvendit nr. 17/2016 është parashikuar ndërprerja e menjëhershme e mandatit të funksionarit publik, në rast se vërtetohet mosplotësimi prej tij i detyrimeve të parashikuara në këto akte ligjore. Pra, përveç shkarkimit nga detyra sipas nenit 140 të Kushtetutës, në nenin 6/1 të saj është parashikuar se nuk mund të ushtrojë mandatin e magjistratit një subjekt që ndodhet në rrethanat e cënimit të integritetit sipas ligjeve të miratuara

me 3/5. Gjithashtu në raport me rastet e mbarimit të mandatit apo shkarkimit të magistratëve, nenit 6/1 i Kushtetutës i është dhënë superioritet duke qënë se shprehimisht është parashikuar *“pavarësisht përcaktimeve të bërë në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute”*. Në zbatim të nenit 6/1 të Kushtetutës, në rast se vërtetohen *“rrethana që çënojnë integritetin e funksionarit publik sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit”*, funksionari publik nuk mund të vazhdojë mandatin, pavarësisht rregullave të posaçme të parashikuar në dispozita të tjera kushtetuese, si neni 140 i Kushtetutës.

20. Në rastin e gjyqtarës Irena Gjoka (Maneku) rezulton që verifikohen *rrethana që çënojnë integritetin e funksionarit publik sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit*”, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e dispozitave ligjore të tre ligjeve të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, që janë në kompetencën lëndore kushtetuese të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

21. Së pari: Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, dhe Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 17/2016 *“Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”*, mandati i magistratit të gjyqtarës Irena Gjoka (Maneku) ka përfunduar, pasi janë vërtetuar të paktën 3 rrethana që çënojnë integritetin e funksionit që ajo ushtron.

21.1 Çdo subjekt që ushtronte një mandat në organet e parashikuara në Kushtetutë apo me ligj, dhe gjykatat e posaçme janë të parashikuara në Kushtetutë, ka qënë i detyruar të vetdeklaronte ekzistencën e rrethanave që çënonin figurën, integritetin, në të kundërt mandati i tyre deklarohet i përfunduar nga organi i emërtesës menjëherë sapo vërtetoheshin këto rrethana, pavarësisht kohës së konstatimit.

21.2 Ligji nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, bashkë me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 17/2016 *“Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”* ka përcaktuar detyrimin e subjekteve që ushtrojnë funksionin e gjyqtarit në datën e hyrjes në fuqi të këtyre akteve të plotësojnë formularin e vetdeklarimit të miratuar prej këtyre akteve, ku duhet të pasqyrojnë çdo dënim penal të dhënë ndaj tyre, të formës së prerë ose jo, si dhe çdo masë dëbimi nga shtete të Bashkimit Europian, pavarësisht kohës së dhënies së tyre. Në nenin 3 të ligjit nr. 138/2015 parashikohet se subjekte të këtij ligji janë edhe gjyqtarët. Në dispozitat e këtij ligji parashikohet se një subjekt i detyruar sipas këtij ligji për të plotësuar formularin e vetdeklarimit, në rast se nuk e plotëson saktë, i ndërpritet mandati menjëherë, përveç se përbën veprën penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal.

21.3 Rregullat e plotësimit të formularit të vetdeklarimit janë parashikuar në Vendimin e Kuvendit nr. 17/2016, në të cilin, Kreu III, pika 1, gërma “ç” parashikohet detyrimi i subjekteve që të deklarojnë **ç) rastet e ndalimit, arrestimit apo dënimit të personit, me**

vendim të formës së prerë ose jo, brenda dhe jashtë Shqipërisë; dhe në pikën d) rastet e dëbimit nga një shtet i huaj.

21.4 Në pikën 3, gërma "d" të të njëjtit Kre, parashikohet se: 3. Formulari i vetëdeklarimit përmban detyrimisht një rubrikë ku pasqyrohet se: ç) pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik.

21.5 Tashmë është vërtetuar që magjistratja Irena Maneku, aktualisht Irena Gjoka ka plotësuar formularin e dekriminalizimit në të cilin nuk ka deklaruar asnjë vendim dënimi, të formës së prerë ose jo, si dhe asnjë masë dëbimi të dhënë ndaj saj.

21.6 Po ashtu në aktin "Parashtrime", gjyqtarja Irena Gjoka (Maneku) shprehet se ka qënë në dijeni të dy masave të dëbimit të dhëna ndaj saj nga autoritetet greke në datën 24.12.2002 dhe 13.02.2003, ka angazhuar një përfaqësues jo avokat, për ndjekjen e procedurave gjyqësore për shfuqizimin e tyre, nuk është njoftuar për shfuqizim të tyre nga autoritetet gjyqësore greke, si dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për marrjen në dijeni të këtyre procedurave gjyqësore të iniciuara prej saj. Duke qënë se gjyqtarja i ka konsideruar të padrejta këto masa, ka vlerësuar të mos i deklaronte në formularin e dekriminalizimit, duke u justifikuar se sipas ligjit shqiptar nr. 79/2021 "Për të Huajt" masa e ndalimit të hyrjes dhe masa e dëbimit janë të ndryshme, dhe sipas saj masa e refuzimit të hyrjes në territorin Grek të ndërmarrë nga autoritetet e kufirit, nuk përfshihet në rastet e ndalesës së parashikuar nga neni 2 i Ligjit nr.138/2015. Përveç sa më sipër, sipas gjyqtares Irena Gjoka (Maneku) kjo e dhënë nuk duhet të shënohet në formularin e dekriminalizimit në kuadër të ligjit nr.138/2015 për shkak se në pikën 7 të këtij formulari shtrohet pyetja: "*A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj me përjashtim të rastit kur jeni dëbuar ekskluzivisht për shkeljen e rregullave të emigracionit që kanë të bëjnë me rregullat e qëndrimit apo hyrjes dalje në një territor të një shtetit të caktuar*".

22. Argumentet e dhëna nga gjyqtarja Irena Gjoka (Maneku) janë tërësisht qesharake dhe nuk duhet të merren parasysh nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, por mund të përdoren nga ky Këshill për të vendosur në diskutim aftësinë argumentuese dhe njohëse të ligjit prej saj.

22.1 Së pari, ligji shqiptar nr. 79/2021 "Për të Huajt" siç qartësisht duket nga viti i miratimit, nuk ka qënë në fuqi as në vitet 2002 dhe 2003 kur janë dhënë masat e dëbimit ndaj gjyqtares Irena Gjoka (Maneku) nga autoritetet e një shteti anëtar të Bashkimit Europian, as në vitin 2015 kur është miratuar ligji nr. 138/2015, apo në vitin 2016 kur është nënshkruar prej saj formulari i dekriminalizimit, por për më tepër, ky ligj, kurdo që të jetë miratuar nuk ka fuqi në Republikën e Greqisë dhe nuk mund të përdoren konceptet e këtij ligji, për të interpretuar ligjin nr. 138/2015 për sa i përket akteve të dëbimit të dhëna nga autoritetet e huaja. Gjyqtarja Irena Gjoka (Maneku) nuk mund të dinte përmbajtjen e ligjit nr. 79/2021 kur ka plotësuar formularin e dekriminalizimit në datën 22.04.2016.

22.2 Së dyti: në lidhje me mënyrën e plotësimit të formularit të dekriminalizimit Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar Vendimin nr. 17/2016, në të cilin, Kreu III, pika 1, gërma “ç” parashikohet detyrimi i subjekteve që të deklarojnë **ç) rastet e ndalimit, arrestimit apo dënimit të personit, me vendim të formës së prerë ose jo, brenda dhe jashtë Shqipërisë; dhe në pikën d) rastet e dëbimit nga një shtet i huaj. Ky Vendim i Kuvendit është pjesë e regjimit juridik të brendshëm, dhe i detyrueshëm për zbatim.** Po në këtë vendim është parashikuar se: “3. Formulari i vetëdeklarimit përmban detyrimisht një rubrikë ku pasqyrohet se: **ç) pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik.** Para se të nënshkruante formularin e vetëdeklarimit, gjyqtarja ka qënë paralajmëruar, se pasqyrimi i të dhënave të paplota, të pasakta, të pavërteta passjell përjashtimin e menjëhershëm nga funksioni. **Në çdo kohë që konstatohet pasaktësia, paplotësia e formularit, pavarësisht kur ka ndodhur fakti, passjell përjashtimin e menjëhershëm të zyrtarit.**

22.3 Së treti: Në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 138/2015 dhe detyrimet e subjekteve të ngarkuara, Gjykata e Lartë ka jurisprudencë të pasur. P.sh. në rastin e një funksionari Drejtor i Tatim Taksave, pranë Bashkisë Selenicë, të dënuar në vitin 2006 për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i KP; dënimi i tij me 2 (dy) muaj burgim dhe 133.400 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind) lekë gjobë (pas uljes së 1/3 së dënimit, për shkak të gjykitimit të shkurtuar), dënimi i të cilit është pezulluar, sipas nenit 59 të KP, me vendimin **Nr. 00-2024-1612 (242)** datë 08.10.2024 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se: “15. Kolegji konstaton se i gjykuari ka qënë një funksionar publik, subjekt i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në momentin e përpilimit të formularit të vetëdeklarimit, dalë në zbatim të këtij ligji, plotësimi i të cilit i jep udhë fillimit të një procedure të mëtejshme verifikimi dhe vlerësimi. Ky shtetas ka pasur detyrimin për të deklaruar me vërtetësi të dhënat e kërkuara në këtë formulër, i cili nuk rezulton të ketë paqartësi apo të jetë i dykuptimtë. Sipas përcaktimeve të ligjit 138/2015 (që prezumohet i njohur nga të gjithë shtetasit) dhe konkretisht nenit 5, pika 3 të tij, rezulton se deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrembëruara, përbën vepër penale, sipas nenit 190 të KP. Përveç këtij parashikimi edhe në vetë formularin e vetëdeklarimit, në rubrikën “Marrje dije mbi efektet e formularit të vetëdeklarimit” (që është para rubrikave që plotësohen prej subjektit deklarues), në pikën “b”, parashikohet se: “Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë formular përbën vepër penale dhe dënohet, sipas nenit 190 të KP”.

Po i njëjti qëndrim i Kolegjit Penal gjendet edhe në vendimet:

- Nr. 00-2023-1033 (187), datë 20.06.2023, i gjykuari ushtronte funksionin e “Këshilltar i Këshillit të Bashkisë Korçë” dhe ishte dënuar me vendim të formës së prerë nr. 29, datë 24.01.1991, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit dhe ishte dënuar me 26 ditë heqje lirie.

- Nr. 00-2023-1678 datë 26.10.2023 i akuzuari kishte qënë punonjës në ish-Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme Sarandë.
- Nr. 00-2023-1677 datë 26.10.2023 i akuzuari kishte qënë Drejtor i Qendrës Shëndetësore Lenie, Gramsh.

22.4 Sipas Gjykatës së Lartë: “16. Qëllimi i këtij ligji, ashtu siç parashikohet në nenin 1 të tij, është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve, sipas këtij ligji. Ndërsa në nenin 2, pika “1” dhe “6”, të këtij ligji përcaktohen shprehimisht ndalimet ligjore, lidhur me identifikimin apo emërimin në organet e zgjedhura shtetërore, institucionet e pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të personave që janë subjekte të nenit 2 dhe 3 të ligjit, kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim. 17. Në nenin 5/3 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” përcaktohet se: “Formulari i vetëdeklarimit plotësohet vetëm nga personi që është subjekt sipas këtij ligji dhe deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrembëruara përbën veprë penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal”. Referuar përmbajtjes së formularit të vetëdeklarimit, i dalë në zbatim të ligjit nr. 138/2015, i miratuar me vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, Kolegji vlerëson se subjektet deklarues që përcaktohen në këtë ligj kanë detyrim të pasqyrojnë në formular çdo dënim penal të formës së prerë të dhënë nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj, pavarësisht llojit të veprës penale dhe llojit e masës së dënimit të dhënë. I pandehuri ka pasur detyrimin ligjor që në këtë formular të pasqyronte me vërtetësi të gjitha të dhënat që kërkoheshin, përfshirë këtu edhe faktin e dënimit të tij me një vendim penal të formës së prerë, llojit dhe masës së dënimit. Këto rrethana mandej do të vlerësoheshin nga autoriteti kompetent në raport me ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, nëse dënimi i dhënë është ose jo kriter ndalimi për t’u zgjedhur në një funksion publik. 18. Në miratimin e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ligjvënësi ka pasur si qëllim detyrimin ligjor të subjekteve të këtij ligji për të deklaruar të dhënat e kërkuara, duke përcaktuar edhe se ku konsiston ky deklarim dhe duke e strukturuar atë në disa kërkesa specifike dhe për një kategori të përcaktuar veprash penale. Në këtë kuptim, të gjitha rregullimet, normimet e bëra në funksion të zbatimit të këtij ligji, të cilat mundësojnë zbatimin e tij, duhen konsideruar dhe interpretuar brenda qëllimit të vetë ligjit, pasi çdo interpretim ndryshe do të sillte denatyrimin të këtij qëllimi/vullneti të ligjvënësit. 19. Detyrimi i caktuar ndaj subjekteve të ligjit, në formularin e vetëdeklarimit, është brenda frymës të vetë ligjit. **Të qënit i dënuar me vendim jopërfundimtar i subjektit të ligjit ose ndaj të cilit janë marrë masa sigurimi apo me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve të parashikuara nga vetë ligji nr. 138/2015,**

përbën shkak ndalues për zgjedhjen ose emërimin e tij në organet të zgjedhura shtetërore, institucionet e pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike etj. apo shkak për largimin e tij nga këto funksione publike. Ndërsa, mosdeklarimi, fshehja, deklarimi i pasaktë ose i rremë nga subjekti deklarues, në formularin e vetëdeklarimit, të çdo dënimi të formës së prerë (të dhënë nga autoritetet gjyqësore shqiptare apo të huaja), përbën paraqitje të rrethanave të rreme para organeve shtetërore, në kuptim të ligjit penal.”

- 22.5** Pra, sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, subjektet e parashikuara në ligjin nr. 138/2015 duhet të deklarojnë çdo dënim, brenda ose jashtë shtetit, dhe çdo dënim. Mandej është detyrë e organit verifikues të përcaktojë nëse përbën pengesë për vazhdimin e mandatit. Vetë mosdeklarimi i dënimit apo dëbimit përbën vepër penale më vete, të cilën magjistratja Irena Gjoka (Maneku) është duke e kryer në vazhdimësi pasi jo vetëm nuk e ka deklaruar në vitin 2016 kur kanë hyrë në fuqi ligjet nr. 138/2015 dhe 96/2016, por vazhdon t'i mohojë, madje pohon që ka qënë në dijeni të dëbimeve, por meqënëse sipas saj ishin të padrejta nuk e ka vlerësuar të arsyeshme t'i deklarojë.
- 22.6** Përsa i përket pretendimeve se janë dhënë për shkelje të rregullave të emigracionit ose jo, nuk i përket subjektit të detyruar të vlerësojë pse po e dëbojnë, por organit që jep masën e dëbimit, dhe nëse përbënte shkak për penalizim, i përket organit që verifikon formularin e dekriminalizimit. Çdo pretendim për grindje me punonjësin e policisë, deklaruar prej gjyqtarës Irena Gjoka, përforcon argumentet për dijeninë e plotë të saj për dëbimin. Referuar Vërtetimit datë 14.08.2025 i lëshuar nga autoritetet policore të Republikës së Greqisë, depozituar prej nesh në Këshillin e Lartë Gjyqësor, rezulton i vërtetuar se në datën 24.12.2002 shtetasja Irena Maneku, është kapur në posedim të pasaportës nr. 1068376 në të cilën ka qënë e vendosur një vizë e falsifikuar. Për këtë shkak nga Komisariati i Policisë Kakavijë i është ndaluar hyrja në Greqi, sipas dispozitave në fuqi për të huaj dhe ndaj saj është filluar procedimi penal, bazuar mbi Ekspertizën Laboratorike të Drejtorisë së Hetimeve Kriministike.
- 22.7** Theksojmë se është e njëjta pasaportë ku është konstatuar viza e falsifikuar për të cilën është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nr. 1447/2005 i Gjykatës Penale të Shkallës së Parë Janinë, vërtetësia e të cilit tashmë është konfirmuar nga Prokuroria e Përgjithshme, dhe po ky institucion ka vërtetuar se pasaporta me nr. 1068376 është lëshuar nga Drejtoria e Policisë Fier. Qëllimit i vizitave të gjyqtarës Irena Gjoka në Greqi shoqëruar me një shtetas, që referuar Vendimit të Kolegjit të Pavarur të Kualifikimit, me të cilin është konfirmuar në detyrë, nuk ka qënë bashkëshorti i saj, por i një shtetaseje tjetër, nuk është i rëndësishëm dhe nuk përbën rrethanë lehtësuese për faktet e kryera prej saj. Gjithsesi, viza e gjetur në pasaportën e saj në datën 24.12.2002 nuk ka qënë turistike, por vizë 100 ditore emigrimi (referuar ligjit nr. 2910/2001), për pasojë qëllimi i vizitës është i qartë.
- 22.8** Pra, shkak për të cilën i është ndaluar hyrja ka qënë kryerja e një vepre penale si ajo e përdorimit të një vize të falsifikuar, provuar me akt ekspertimi, që ndryshe nga sa ka deklaruar në parashtrimet e saj gjyqtarja Irena Gjoka (Maneku) referuar Vendimit

nr. 1447/2005 i Gjykatës Penale të Shkallës së Parë Janinë parashikohet si vepër penale nga nenet 4, 12, 16, 26 paragrafi 1a, 27 paragrafi 1, 51, 53. 79 94 paragrafi 1 Kodit Penal dhe neni 54&7 i ligjit 2910/2001. Po ashtu masa e dëbimit është dhënë për cënim të rendit publik, siç rezulton në përmbajtjen e vendimit administrativ gjyqësor të çështjes së iniciuar nga gjyqtarja Irena Gjoka (Maneku) për shfuqizimin e tyre.

23. Së dyti: Po ashtu “integriteti” i magjistratëve në mënyrë individuale, për pasojë edhe i pushtetit gjyqësor në tërësi, mbrohet edhe nga dispozitat e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka hyrë në fuqi në datën 22.11.2016.

23.1 Në nenin 28 të këtij ligji në gjermën “d” të tij parashikohet se nuk mund të ketë statusin e magjistratit një shtetas që është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në nenin 66/3 të të njëjtit ligj, të hyrë në fuqi në datën 22.11.2016, parashikohet lindja e detyrimit për çdo magjistrat të njoftojë menjëherë Këshillin e Lartë Gjyqësor për ekzistencën e një kushti që shkakton mbarimin e mandatit, apo pazgjedhshmërisë.

23.2 Nga Vendimi nr. 1447/2005 i Gjykatës Penale të Shkallës së Parë Janinë, magjistratja Irena Maneku, aktualisht Irena Gjoka, është dënuar për kryerjen e krimit të “falsifikimit të pasaportave, vizave” me burg i cili i është konvertuar me gjobë. Prokuroria e Përgjithshme ka vërtetuar autenticitetin e këtij vendimi.

23.3 Referuar Formularit të Vetdeklarimit të dorëzuar nga magjistratja Irena Gjoka në datë 22.04.2016, i cili gjendet i publikuar në zbatim të ligjit nr.138/2015, rezulton që magjistratja të mos ketë deklaruar Vendimin nr. 1447/2005 i Gjykatës Penale të Shkallës së Parë Janinë me të cilin është dënuar për kryerjen e një krimi, ashtu dhe si masat e dëbimit të marra ndaj saj.

24. Në aktin “Parashtime” të gjyqtarës Irena Gjoka (Maneku) të publikuar dhe pakundërshtuar prej saj, ngrihen pretendime në lidhje me mungesën e formës së prerë të këtij vendimi, si dhe me procedurat gjyqësore të ndjekura nga autoritetet e huaja gjyqësore, të cilat sipas saj kanë qënë të padrejta.

24.1 Përsa i përket pretendimeve në lidhje me procedurat gjyqësore, pretendimin e saj se ka patur një vizë të rregullt të marrë në Konsullatën përkatëse, apo në lidhje me datën e sekuestrimit të pasaportës, njoftimit etj, kanë të bëjnë me procedura gjyqësore të autoriteteve të huaja gjyqësore, të cilat gjyqtarja Irena Gjoka mund t’i ngrejë me ankim para atyre autoriteteve, sipas ligjit të zbatueshëm në atë shtet.

24.2 Përsa i përket pretendimeve se për shkak të zbatimit të Ligjit 3346/17.06.2005, që sipas saj e bën të paqënë procedurën penale në ngarkim të saj, parashtrojmë se:

24.3 Së pari: Është provuar tashmë që gjyqtarja Irena Gjoka (Maneku) është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një krimi, i cili parashikohet i tillë në të dy

shtetet, si në vendin ku është kryer vepra penale, po ashtu edhe në Shqipëri, konkretisht “Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave”.

24.4 Së dyti: përsa i përket procedurave të Ligjit 3346/17.06.2005, si pasojë e të cilit subjektet e dënuar, nuk mund të ankimonin vendimin e dënimit, si dhe në rast se vendimi ishte i pakthyeshëm, nuk kryenin dënimin e dhënë, duke u vendosur në provë për 18 muaj, ky ligj nuk “shfajëson” gjyqtaren Irena Gjoka (Maneku) siç shprehet ajo. Vendimi i GJEDNJ, i paraqitur prej saj, është përkthyer dhe lexuar gabim nga gjyqtarja, ashtu siç përkthehet dhe lexohet gabim vendimi i dënimit të saj, ashtu dhe shkresa e prokurorisë për arkivimin e dosjes, akti i dëbimit, etj. **Në vendimin e Panos, GJEDNJ pranon se është në përputhje me KEDNJ që Greqia në një situatë të ngjashme, largoi nga puna Panos, që në fund të fundit ishte police. Imagjino besueshmëria që duhet të ketë një gjyqtar.** Kurse Irena Gjoka shton fjalë në shkresa, ose heq paragrafë të tërë, duke shkelur etikën edhe në këtë akt që paraqet në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

24.5 Arkivimi i vendimit të dënimit të saj, sipas gjyqtarës është kryer sipas Nenit 32, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit 3346/05. Përmbajtja e këtij neni gjendet në vendimin e GJEDNJ-së çështja Panos kundër Greqisë (nr. 44058/05, 8 janar 2009) në të cilin citohet se: *“Dënimet e dhëna me vendime të shpallura deri në botimin e këtij ligji, me kohëzgjatje deri në gjashtë muaj, me kusht që ato të mos jenë bërë të pakthyeshme dhe të mos jenë vuajtur domosdoshmërisht deri në botimin e këtij ligji, parashkruhen dhe nuk ekzekutohen me kusht që personi i dënuar brenda tetëmbëdhjetë muajve nga botimi i këtij ligji të mos kryejë një vepër të re penale të kryer me dashje, për të cilën ai do të dënohet në mënyrë të pakthyeshme në çdo kohë me një dënim me heqje lirie mbi gjashtë muaj”.*

24.6 Pra kanë qënë dy raste që parashikonte ky nen, i- vendimet që nuk ishin bërë të pakthyeshme, dhe ii- vendimet që nuk ishin ekzekutuar. Vendimi i gjyqtarës Irena Gjoka (Maneku) ka qënë i paekzekutuar. **Por kryesorja është që tashmë edhe gjyqtarja Irena Gjoka (Maneku) pranon në parashtrimet e saj që vendimi nr. 1447/2005 i Gjykatës Penale të Shkallës së Parë Janinë me të cilin është dënuar për kryerjen e një krimi është i paankimueshëm prej saj, për shkak të zbatimit të Ligjit 3346/05, i cili kishte për qëllim lehtësimin e procedurave në gjykatat e apelit në Republikën Helene.**

24.7 Po i njëjti interpretim është kryer nga GJEDNJ në çështjen Panos kundër Greqisë (nr. 44058/05, 8 janar 2009), të cilat e konsiderojnë një çështje penale të papërfunduar me vendim, si të pushuar në kuptimin pa pasoja për të dënuarin, (jo shfajësim siç e përkthen gjyqtarja Irena Gjoka), pasi vendimi i dënimit nuk ekzekutohet, **por në çdo rast, vendimet janë të paankimueshme. Vendimet gjyqësore të paankimueshme janë vendime të formës së prerë.**

24.8 Referuar nenit 28 të ligjit nr. 96/2016, por ashtu dhe dispozitat e ligjit nr. 138/2015 nuk kanë përjashtime për vendimet e amnistuara, parashkruara, rehabilituara. Ndryshimi ndërmjet zbatimit të nenit 28 të ligjit nr. 96/2016 me ligjin nr. 138/2015 janë tek dijenia e dënimit.

Neni 28 i ligjit nr. 96/2016, mbarimin e mandatit nuk e lidh me dijeninë e vendimit të dënimit, por vetëm me ekzistencën e faktit të dënimit. Kjo pasi dënimi është rezultat i një veprimi në kundërshtim me ligjin penal të një magjistrati dhe një magjistrat i tillë nuk mund të qëndrojë në detyrë, pavarësisht nëse e di apo jo rezultatin e procesit penal.

25. Në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 138/2015 dhe detyrimet e subjekteve të ngarkuara me vendimin **Nr. 00-2024-1612 (242) datë 08.10.2024** i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i cituar më lart, ka arsyetuar se: **“Referuar përmbajtjes së formularit të vetëdeklarimit, i dalë në zbatim të ligjit nr. 138/2015, i miratuar me vendimin nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, Kolegji vlerëson se subjektet deklarues që përcaktohen në këtë ligj kanë detyrim të pasqyrojnë në formular çdo dënim penal të formës së prerë ose jo të dhënë nga një autoritet gjyqësor shqiptar apo i huaj, pavarësisht llojit të veprës penale dhe llojit e masës së dënimit të dhënë.** Subjekti ka pasur detyrimin ligjor që në këtë formular të pasqyronte me vërtetësi të gjitha të dhënat që kërkoreshin, përfshirë këtu edhe faktin e dënimit të tij me një vendim penal të formës së prerë, llojit dhe masës së dënimit. Këto rrethana mandej do të vlerësoheshin nga autoriteti kompetent në raport me ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, nëse dënimi i dhënë është ose jo kriter ndalimi për t’u zgjedhur në një funksion publik.

26. Në lidhje me mbarimin e mandatit për shkak të rrethanave të pazgjedhshmërisë, praneve 28 dhe 66 të ligjit nr. 96/2016 tashmë ka një interpretim të GJEDNJ në çështjen Cani kundër Shqipërisë (Kërkesa nr. 37474/20). **Bazuar në nenin 116 dhe 122 të Kushtetutës Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe vendimet e GJEDNJ janë pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe kanë epërsi ndaj çdo dispozite ligjore.** Në rastin e vendimit Cani kundër Shqipërisë GJEDNJ është shprehur: “83. Në vendimin e saj në çështjen Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës (cituar më sipër, § 218 e në vijim), Dhoma e Madhe e Gjykatës sqaroi fushën e veprimit të, dhe kuptimin që i jepej, konceptit një “gjykatë e krijuar me ligj”. Gjykata analizoi komponentët individual të atij koncepti dhe gjykoi se si duhej të interpretoheshin në mënyrë që të reflektohej qëllimi i tij, dhe domosdoshmërisht, të garantohej se mbrojtja që ofronte ishte me të vërtetë efikase. 84. Në lidhje me nocionin një “gjykatë”, përveç detyrimeve që lindnin nga praktika gjyqësore e Gjykatës, Gjykata theksoi rëndësinë e padiskutueshme të një procesi rigoroz për emërimin e gjyqtarëve për t’u garantuar se në postet gjyqësore do të emëroheshin kandidatët më të kualifikuar si në aspektin e kompetencës teknike edhe të integritetit moral. Gjykata nënvizoi se sa më lartë në hierarki të pozicionohej një gjykatë, aq më kërkuese duhej të ishin kriteret e aplikueshme për përzgjedhjen. Në opinionin e Gjykatës, një përzgjedhje e tillë e mbështetur në merita nuk garanton vetëm kapacitetin teknik të një organi gjyqësor në dhënien e drejtësisë si një “gjykatë”, por është e rëndësishme edhe për të siguruar besimin e publikut në gjyqësor (po aty, § 222). 85. Në lidhje me termin “krijuar”, Gjykata konstatoi se procesi për emërimin e gjyqtarëve në mënyrë të domosdoshme përfshinte një element të rëndësishëm të konceptit “krijuar me ligj”, duke pasur në konsideratë rëndësinë e saj themelore për funksionimin e duhur dhe legjitimitetin e gjyqësorit në një shtet

demokratik të udhëhequr nga shteti i së drejtës. Në gjykimin e Gjykatës shkeljet e ligjit që rregullon procesin e emërimeve në gjyqësor mund të sillnin pjesëmarrjen "e parregullt" të gjyqtarit konkret në shqyrtimin e një çështje (po aty, §§ 226–227). 86. Në lidhje me shprehjen "me ligj", Gjykata sqaroi se edhe komponenti i tretë nënkuptonte një "gjykatë e krijuar në përputhje me ligjin". Ajo vlerësoi se ligji respektiv vendës për emërimet në gjyqësor duhej të shprehej në terma sa më të qartë të ishte e mundur, në mënyrë që të mos lejoheshin ndërhyrje arbitrare në procesin e emërimit (po aty, §§ 229–230). 87. Në vijim Gjykata theksoi se edhe pse e drejta për një "gjykatë të krijuar me ligj" ishte një e drejtë e pavarur, sipas nenit 6 § 1 të Konventës, një ndërlidhje shumë e afërt ishte formuluar në praktikën gjyqësore të Gjykatës midis asaj të drejte specifike dhe garancive për "pavarësi" dhe "paanshmëri". Kërkesat institucionale të nenit 6 § 1 shprehnin qëllimin e zakonskëm për ruajtjen e parimeve themelore të shtetit të së drejtës dhe ndarjen e pushteteve (po aty, §§ 231–233). 88. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata theksoi se parimi i shtetit të së drejtës përfshin një numër parimesh të tjera po aq të rëndësishme dhe mundësisht kundërbalacuese (po aty, §§ 237–240). Këto parime përfshijnë veçanërisht sigurinë ligjore dhe respektin për forcën e res judicata, si edhe parimin e palëvizshmërisë së gjyqtarëve gjatë mandatit të tyre; shmangia nga këto parime mund të justifikohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe të mirëpërcaktuara. U takon autoriteteve kombëtare që në secilën çështje "të përcaktojnë nëse ka një nevojë të domosdoshme— të një karakteri të rëndësishëm dhe detyrues— që justifikon shmangien" nga parimet e sigurisë ligjore dhe të besimit në publik në gjyqësor "në rrethanat e veçanta të një çështje" (po aty, § 240). 89. Për të vlerësuar nëse parregullsitë në një procedurë të caktuar për emërimet në gjyqësor ishin aq serioze sa të pasillnin shkeljen e së drejtës për një gjykatë të themeluar me ligj, dhe nëse balanca midis parimeve detyruese është prishur nga autoritetet shtetërore, Gjykata përgatiti një test matës të përbërë nga tri kritere, të përzgjedhura në mënyrë kumulative (po aty, § 243). 90. **Fillimisht, në parim, duhet të ekzistojë një shkelje e dukshme e ligjit vendës**, në kuptimin që shkelja duhet të jetë e identifikueshme në mënyrë objektive dhe të vërtetë. Në përcaktimin e këtij aspekti, Gjykata do të mbështetet në interpretimin e gjykatave vendëse, për faktin nëse ka pasur një shkelje të ligjit vendës, në rast se shkelja nuk është "flagrante"— që do të thotë, nëse konstatimet e gjykatave vendëse nuk mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Megjithatë, mungesa e një shkeljeje të tillë nuk përjashton mundësinë e shkeljes së të drejtës për një gjykatë të krijuar me ligj, duke qenë se një procedurë e cila duket se është në përputhje me rregullat vendëse, gjithsesi mund të sjellë rezultate, të cilat nuk janë në përputhje me objektin dhe qëllimin e asaj të drejte. Në një rast të tillë, Gjykata, sipas rastit, duhet të bëjë shqyrtimin e saj sipas kriterit të dytë dhe të tretë të testit, paraqitur në vijim, për të përcaktuar nëse rezultatet e zbatimit të rregullave konkret vendës kanë qenë në përputhje me kërkesat specifike të së drejtës për një "gjykatë të krijuar me ligj" sipas kuptimit në Konventë (po aty, §§ 244–245). 91. **Së dyti, shkelja konkrete duhet të vlerësohet sipas objektit dhe qëllimit të kërkesës për një "gjykatë të krijuar me ligj"**— më konkretisht, të garantohet se gjyqësori realizon detyrat e tij i pavarur nga ndërhyrje të parregullta dhe në këtë mënyrë ruan shtetin e së drejtës dhe ndarjen e pushteteve. Sipas rrethanave, shkeljet e një natyre tërësisht teknike, të cilat nuk kanë

ndikim në legjitimitetin e procesit të emërimeve duhet të konsiderohen se janë nën pragun konkret. Nga ana tjetër, shkeljet të cilat cenojnë rregullat më themelore në procedurën e emërimeve (të tillë si kriteret e përzgjedhshmërisë) ose shkeljet që mund të dëmtojnë qëllimin dhe ndikimin e kërkesës “të krijuar me ligj” (sipas interpretimit të Gjykatës) duhet të konsiderohen se e shkelin atë kërkesë (po aty, § 246). 92. *Së treti*, shqyrtimi i realizuar nga gjykatat vendëse, nëse ka ndonjë të tillë, për pasojat ligjore për sa u përket të drejtave të një individi sipas Konventës— e një shkeljeje të një rregulli të brendshëm, në lidhje me emërimet gjyqësore luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin nëse një shkelje e tillë ka cenuar të drejtën e aksesit në një “gjykatë të krijuar me ligj”, dhe në këtë mënyrë, bëhet pjesë e vet testimit. Një vlerësim nga gjykatat vendëse të efekteve ligjore për një shkelje të tillë duhet të kryhet në mbështetje të praktikës gjyqësore përkatëse të Konventës dhe parimeve që burojnë prej saj (po aty, §§ 248 dhe 250). 93. Gjykata e ka zbatuar testimin e mësipërm në një sërë çështjesh të kohëve të fundit që kanë lidhje me kërkesën në nenin 6 §1 të Konventës se një gjykatë duhet të krijohet me ligj (shih, çështjet më të fundit, *Advance Pharma sp. Z o.o kundër Polonisë*, nr. 1469/20, § 349, 3 shkurt 2022; *Dolińska-Ficek dhe Ozimek kundër Polonisë*, nr. 49868/19 dhe 57511/19, § 353, 8 nëntor 2021; *Reczkoëicz kundër Polonisë*, nr. 43447/19, § 280, 22 korrik 2021; dhe *Xero Flor ë Polsce sp.z o.o. kundër Polonisë*, nr. 4907/18, §289, 7 maj 2021). ”

27. Po në këtë vendim GJEDNJ ka kryer interpretim në lidhje me kriteret e pazgjedhshmërisë së gjyqtarëve sipas ligjit të brendshëm për statusin e gjyqtarëve (ligji nr. 96/2016, i ndryshuar) i cili hyri në fuqi më 22 nëntor 2016 dhe parashikon rregullat për statusin e magjistratëve— që do të thotë të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Neni 28, në formën e tij në ditën e hyrjes në fuqi parashikon kriteret që duhet të përmbushë një individ për t’u emëruar si magjistrat; pika “d” e këtij neni parashikon se një individ ka të drejtën të aplikojë për t’u pranuar në kursin e trajnimit fillestar për magjistratët, nëse ai ose ajo nuk “është dënuar me vendim penal të formës së prerë”.

27.1 Neni 66 i ligjit parashikon: “1. Statusi i magjistratit mbaron në ditën kur autoriteti kompetent përcakton me vendim shkaqet e pazgjedhshmërisë, si vijon: a) kur magjistrati nuk plotëson kriteret e përcaktuara, sipas nenit 28 të këtij LIGJI; b) kur vendimi i emërimit është i pavlefshëm dhe nuk sjell asnjë pasojë juridike, si edhe konsiderohet se nuk ekziston. ... 4. Këshilli [i Lartë Gjyqësor] deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë nga marrja e njoftimit për shkakun e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë. 5. Vendimi përcakton datën e mbarimit të statusit të magjistratit, sipas parashikimit të pikës 1 ose 2 të këtij neni. 6. Çdo veprim i kryer nga magjistrati pas kësaj date është i pavlefshëm dhe konsiderohet që nuk sjell asnjë pasojë juridike, si dhe konsiderohet se nuk ekziston.”.

27.2 Në interpretim të shkaqeve të pazgjedhshmërisë së magjistratit, të cilat përbëjnë edhe shkak për mbarimin e statusit, GJEDNJ ka vijuar në këtë vendim arsyetimin: “102. Nga ana tjetër, ankuesi parashitroi— dhe Gjykata ra dakord— se rregulli konkret synonte të ruante legjitimitetin dhe besimin e publikut te procesi i rivlerësimit. Edhe Gjykata priret të jetë dakord me gjykatat vendëse, të cilat— për aq sa ato e trajtuan këtë çështje sipas kontekstit të

procesit penal ndaj L.D.– bënë deklarata të ngjashme në lidhje me rëndësinë e kërkesës për përzgjedhshmërinë të parashikuar në nenin 6(1)(dh) të ligjit të rivlerësimit (shih paragrafët 25 dhe 29 më sipër). **Është e qartë se emërimi i një personi i cili nuk përmbush kriteret statutores për një post të caktuar në gjyqësor mund të dëmtojë legjitimitetin e funksionit gjyqësor në fjalë. Sipas Gjykatës, rëndësia e kriterëve statutores të përzgjedhshmërisë për gjyqtarët është e qartë edhe në ligjin për gjyqtarët dhe prokurorët, i cili parashikon se mosrespektimi i kriterëve të përzgjedhshmërisë çon në ndërprerjen e mandatit të magjistratit në datën e vendimit, i cili e njeh një mosrespektim të tillë dhe pavarësisht periudhës që prej emërimit të parë (shih paragrafin 53 më sipër).¹**

- 27.3 Në vijim, në pikën 103 të këtij vendimi Gjykata është shprehur se “**emërimi në KPA i një kandidati, i cili më herët është shkarkuar nga detyra për një shkellje të ligjit dhe për paafësi (shih paragrafët 9 dhe 51 më sipër) vështirë se mund të pajtohet me kërkesën, që sa më lartë të jetë niveli i një gjykate në hierarkinë e gjyqësorit, më kërkuese duhet të jenë kriteret e zbatueshme të përzgjedhjes (shih paragrafin 84 më sipër).**
- 27.4 Në pikën 105 të vendimit GJEDNJ në lidhje me padijeninë e organeve shtetërore në lidhje me masën disiplinore të caktuar ndaj gjyqtarit L.D., ka argumentuar se “**...Gjykata vlerëson se Shtetet kanë një detyrim të përgjithshëm për të organizuar sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të tillë që të sigurojnë pajtueshmërinë me kërkesat e nenit 6 § 1 (shih, mutatis mutandis, Krastanov kundër Bullgarisë, nr. 50222/99, § 74, 30 shtator 2004).**”
- 27.5 Bazuar në sa më lart, referuar dispozitave në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016 një gjyqtar i cili në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji rezultonte I dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë humbiste “mandatin” e magjistratit, bazuar në nenet 28/1 gërma “d”, neni 64 dhe 66 të këtij ligji, duke qënë në kushtet e pazgjedhshmërisë.
- 27.6 GJEDNJ në vendimin Cani të cituar më lart ka interpretuar pikërisht parashikimet ligjore të ndërprerjes së mandatit të magjistratit sipas ligjit nr. 96/2016. **Sipas Gjykatës, rëndësia e kriterëve statutores të përzgjedhshmërisë për gjyqtarët është e qartë edhe në ligjin për gjyqtarët dhe prokurorët, i cili parashikon se mosrespektimi i kriterëve të përzgjedhshmërisë çon në ndërprerjen e mandatit të magjistratit në datën e vendimit, i cili e njeh një mosrespektim të tillë dhe pavarësisht periudhës që prej emërimit të parë.**”
- 27.7 Pra, referuar parimeve të vendosura nga GJEDNJ në vendimin e mësipërm, **së pari** provohet që ekziston shkellje e dukshme e ligjit, konkretisht e dy ligjeve, ligjit nr. 138/2015, pasi magjistratja Irena Gjoka nuk ka vetdeklaruar një dënim penal dhe dy dëbime nga një shtet i Bashkimit Europian, dhe vetëm mungesa e deklarimit është shkak për ndërprerjen e mandatit, përveç veprës penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal, si dhe shkellje e nenit 66 dhe 28 të ligjit nr. 96/2016 pasi në kushtet e dënimit të saj për kryerjen e një krimi

¹ Citim i vendimit të GJEDNJ çështja BESNIK CANI KUNDËR SHQIPËRISË (Kërkesa nr. 37474/20)

ajo nuk mund të vazhdonte të qëndronte magjistrate dhe me dashje nuk ka njoftuar Këshillin e Lartë Gjyqësor, në shkelje të nenit 66/3 të ligjit nr. 96/2016. **Së dyti:** në lidhje me rëndësinë e shkeljes ligjore të kryer nga magjistrati ajo duhet të jetë e tillë që të cënojë parimin e “gjykatës së krijuar me ligj”. Në rastin e magjistrates Irena Gjoka, ajo ndodhet në kushtet e mbarimit të mandatit sipas dy ligjeve me 3/5, dhe në zbatim të nenit 6/1 të Kushtetutës, shkelja ligjore në vazhdimin e mandatit të saj është flagrante, nuk mund të konsiderohet “teknike”. **Së treti:** sa më lartë në hierarkinë gjyqësore ndodhet magjistrati përkatës aq më të forta duhet të jenë kriteret e përzgjedhjes pasi integriteti i tyre cënon integritetin e sistemit. Magjistratja Irena Gjoka ushtron funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që është institucion kushtetues, pra jo i krijuar me ligj, por i parashikuar në Kushtetutë, duke ju dhënë në këtë mënyrë rëndësi e posaçme. Për më tepër në momentin e publikimit të njoftimeve për ekzistencën e rrethanave që ndërprisnin mandatin e saj, ka ushtruar detyrën e Kryetares së kësaj Gjykate. Po ashtu në ligjin nr. 95/2016 janë vënë kritere më të forta përzgjedhëse për magjistratët që ushtrojnë funksionet në institucionet e posaçme të drejtësisë, që dëshmon se legjislatori me një ligj tjetër me 3/5 me qëllim garantimin që në këto institucione të emërohen gjyqtarë me integritet dhe figurë të pacënuar dhe të pacënueshme, dhe madje pas emërimit këtyre funksionarëve u garantohet pothuajse pamundësia e shkarkimit pasi kërkojnë shumicë të cilësuar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

27.8 GJEDNJ shpesh është shprehur se është detyrë e shtetit të marrë të gjitha masat e mundshme për garantimin e “gjykatës së krijuar me ligj”, edhe në rastin konkret, si tek rasti Cani kundër Shqipërisë, autoritetet shtetërore kanë dështuar të verifikojnë pretendimet për mosrespektimin e kriterëve të përzgjedhshmërisë së gjyqtarës Irena Gjoka. Në muajin mars e në vijim të vitit 2024 në media elektronike në Shqipëri janë publikuar të dhëna të sakta, përfshirë përmbajtjen e vendimit të dënimit të gjyqtarës Irena Gjoka, si dhe të dhëna në lidhje me faktin penal për të cilin ka qënë e dënuar, duke dhënë indicie të forta për të evidentuar vendin/gjykatën ku gjendej ky vendim. KLGj jo vetëm që nuk kreu detyrën e parashikuar në nenin 66/4 të ligjit nr. 96/2016, por me deklaratë për shtyp të datës 4 mars 2024 KLGj publikisht pohoi se nuk ishte duke kryer dhe nuk do të kryente ndonjë verifikim në lidhje me kushtet e përzgjedhshmërisë së gjyqtarës Irena Gjoka.

27.9 Pra shteti dështoi të përmbushte detyrimin e përgjithshëm për të organizuar sistemin e tij ligjor, në mënyrë të tillë që të siguronte pajtueshmërinë me kërkesat e nenit 6 § 1 (shih, mutatis mutandis, Krastanov kundër Bullgarisë, nr. 50222/99, § 74, 30 shtator 2004).”.

B. Në lidhje me objektin e kërkesës për “Pavlefshmërinë e emërimit të gjyqtarës Irena Gjoka në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

28. Sipas nenit 162 të ligjit nr. 96/2016: “1. Gjyqtari në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ose Gjykatën e Apelit për Krimeve të Rënda qëndron në pozicionin e tij deri në momentin e krijimit të gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të

korupsionit dhe krimit të organizuar, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit, në zbatim të pjesës III, kreu VIII, të këtij ligji, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

29. Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjeve nr. 95/2016 dhe 96/2016, gjyqtarja Irena Gjoka (Maneku) ka qënë duke ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, por ka qënë në kushtet e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak të dënimit me vendim penal të formës së prerë, të cilin e pranon edhe vetë gjyqtarja në parashtimet e saj, që është i paankimueshëm, për kryerjen e një krimi. Ka qënë detyrë e gjyqtares, sipas nenit 104 të të njëjtit ligj, të njoftonte KLGj, e cila brenda 2 javëve duhet të shprehej në lidhje me mbarimin e mandatit të saj. Kjo gjendje ka ekzistuar që në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, në datën 22.11.2016, ligj i cili është ligj i miratuar me 3/5 pavarësisht kohës së konstatimit të rrethanave, sipas nenit 6/1 të Kushtetutës.

30. Gjithashtu, sipas nenin 6/1 të Kushtetutës, dhe dispozitave të ligjit nr. 138/2015 Gjyqtarja Irena Gjoka ka patur disa herë detyrim të vetdeklaronte dënimin e saj për kryerjen e një krimi në vitin 2005, si dhe masat e dëbimit të dhëna ndaj saj nga autoritetet e një shteti anëtar të Bashkimit Europian, për të cilat në parashtimet e paraqitura në Këshillin e Lartë Gjyqësor, pranon dijeninë. **Nëse Irena Gjoka-Maneku-Shpata thotë nuk kisha dijeni për procedurat penale ku ka marrë pjesë vetë, dhe ka vendim penal, çfarë duhet thonë gjyqtarët e larguar nga vetingu për shkelje besimi të drejtësisë, për fakte para 30 vjetësh, nga persona të lidhur, që për më tepër ishin ligjërues nga ILDKP për vite me radhë.** Deklarimet e paplota në formularin e dekriminalizimit janë shkak për mbarimin e menjëhershëm të mandatit, përveç kryerjes së një vepre tjetër penale, atë "falsifikimit të formularëve" të parashikuar nga neni 190 i K.Penal.

31. Ngritja në detyrë, nëpërmjet emërimit në Gjykatën e Posaçme të Krimeve të Rënda e gjyqtares Irena Gjoka është absolutisht e pavlefshme, pasi në momentin e emërimit në atë gjykatë, nuk ka patur statusin e magjistrates, sipas dispozitave të dy ligjeve të miratuara me 3/5 të anëtarëve të Kuvendit dhe nenit 6/1 të Kushtetutës. Neni 162 i ligjit nr. 96/2016 ka parashikuar kusht thelbësor për emërimin në gjykatën e posaçme pikërisht mosekzistencën e kushteve të mbarimit të mandatit të magjistratit. Siç rezulton edhe nga parashtimet e paraqitura nga gjyqtarja Irena Gjoka (Maneku), ajo ka qënë në dijeni të fakteve të vendimit penal, të dy masave të dëbimit, të cilat nuk i ka deklaruar e nënshkruar prej saj në datën 22.04.2016, si dhe rezulton e dënuar me vendim penal, për të cilin në parashtimet e saj e pranon që është i paankimueshëm sipas ligjit të brendshëm në vendin e Bashkimit Europian ku është dhënë.

Përfundimisht kërkojmë Zbatimin e ligjit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor duke shpallur:

- Deklarimin e mbarimit të mandatit të “magjistratit” për Gjyqtaren Irena Gjoka, gjyqtare në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar bazuar në nenin 66/1 gërma “a” të ligjit nr. 96/2016, ligjit nr. 138/2015 dhe nenit 6/1 të Kushtetutës.
- Pavlefshmërinë e emërimit të gjyqtarës Irena Gjoka në Gjykatën e Posaçme të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për shkak të mospasjes së statusit të “magjistrates” në momentin e emërimit në atë Gjykatë, bazuar në nenet 66/1 gërma “b” dhe 162 të ligjit nr. 96/2016.

KËRKUES

Prof. Dr. Jamarbër MALLTEZI

